

VAKSINIME PËR TË GJITHË

Vaksinat kundër COVID-19 për gra që janë apo kanë qenë së fundi shtatzëna, në gjidhënie ose që planifikojnë të mbetet shtatzëna

Pyetje të shpeshta

Shëndeti dhe siguria juaj dhe e foshnjës suaj janë prioriteti ynë. Gratë që janë shtatzëna apo që kanë qenë të tilla kohëve të fundit kanë rrezik më të lartë për sëmurje të rëndë nga COVID-19.

Bërja e vaksinës kundër COVID-19 është mënyra më e mirë për të parandaluar sëmundjen dhe për të mbrojtur veten, foshnjën dhe familjen tuaj nga COVID-19.

Përse duhet ta bëj vaksinën kundër COVID-19?

Gratë shtatzëna ose në gjidhënie janë në rrezik më të lartë që të sëmuren rënde me COVID-19. Ato mund të kenë vështirësi në frymëmarrje ose dhimbje gjoksi që mund të kërkojnë kujdes spitalor apo intensiv. Nëse jeni 35 vjeç e lart ose mbipeshë dhe keni hipertension apo diabet, mund të rrisni rrezikun e sëmurjes së rëndë gjatë apo menjëherë pas shtatzënisë. Vaksinimi

ju ndihmon sistemin imunitar që t'ju mbrojtë juve, foshnjë dhe familjen tuaj.

A janë të sigurta vaksinat kundër COVID-19?

Po. Studimet tregojnë se vaksinat kundër COVID-19 janë të sigurta për përdorim gjatë shtatzënisë dhe jo të dëmshme për shtatzënë apo fetusin. Në fakt ka dhe vakcina të tjera që bëhen gjatë shtatzënisë, duke përfshirë Tdap (tetanozi, difteria dhe kolla e mirë) dhe vaksinat e gripit. Vaksinat janë të sigurta dhe efikase në parandalimin e sëmundjes.

A është e sigurt vakcina për familjen time?

Po. Është e rëndësishme që gjithkush rreth foshnjës suaj të jetë plotësisht i vaksinuar. Foshnja juaj ka sistem të ri imunitar dhe është vulnerabël ndaj COVID-19. Duke u siguruar që njerëzit tuaj të dashur të vaksinohen, ndihmoni në mbrojtjen e shëndetit të foshnjës suaj dhe reduktoni gjasat e infektimit.

A është e sigurt të ushqej me gji foshnjë pas bërjes së vaksinës kundër COVID-19?

Po. Gratë e vaksinuara dhe në gjidhënie zhvillojnë antitrupa që mbrojnë kundër COVID-19.

Pas bërjes së vaksinës antitruapat ndodhen në qumështin tuaj të gjirit. Foshnja i ushqyer me gji do t'i marrë këto antitrupa dhe do të ketë njëfarë mbrojtjeje nga COVID-19.

Si do të ndihem pas bërjes së vaksinës kundër COVID-19?

Mund të keni efekte anësore, si p.sh. të përziera, temperaturë, lodhje dhe dhimbje muskujsh. Këto efekte anësore janë normale dhe duhet të largohen pas pak ditësh. Mjekimet mund të ndihmojnë me disa nga efektet. Pyesni ofruesin tuaj se cili mjekim është i duhuri për ju. Nëse keni pasur një reaksion alergjik ndaj një vaksine në të kaluarën, flisni me ofruesin tuaj përpara kryerjes së vaksinës kundër COVID-19.

A do të më dëmtojnë mua apo foshnjën këto efekte anësore?

Jo. Pasja e efekteve e anësore pas vaksinës do të thotë se trupi juaj po krijon mbrojtje kundër COVID-19. Efektet anësore nga vaksina janë të zakonshme, zakonisht të lehta dhe nuk do ta dëmtojnë foshnjën tuaj.

A mund të më shkaktojë abort vaksina kundër COVID-19?

Jo. Studimet tregojnë se vaksina kundër COVID-19 është e sigurt për t'u kryer gjatë shtatzënisë. Gratë që e bëjnë vaksinën nuk kanë rrezik më të lartë aborti se ato që nuk e bëjnë.

A mund të shkaktojë defekte në lindje vaksina kundër COVID-19?

Jo. Vaksina kundër COVID-19 nuk mund ta ndryshojë ADN-në tuaj apo të foshnjës suaj. Nuk ka raportime problemesh në lindje mes mijëra grave që kanë kryer vaksinën kundër COVID-19 përpara apo gjatë shtatzënisë.

A do të ndikojë vaksina kundër COVID-19 te fertiliteti im?

Jo. Nuk ka fakte se vaksina kundër COVID-19 ndikon në fertilitet apo se shkakto probleme me fertilitetin te femrat apo meshkujt.

A do të ndikojnë në fertilitetin tim antitruapat që do të krijoj pas bërjes së vaksinës kundër COVID-19?

Jo. Antitruapat do të luftojnë virusin që shkakton COVID-19. Këta antitrupa nuk do të ndikojnë në organet tuaja riprodhuese apo në fertilitet.

Çfarë do të ndodhë nëse nuk vaksinohem dhe zë COVID-19 ndërsa jam shtatzënë ose kur jam duke lindur?

Shtatzënat që nuk vaksinohen kundër COVID-19 janë në rrezik më të lartë aborti, lindjeje të parakohshme, preeklampsie dhe lindjeje fëmije të vdekur. Ka gjithashtu rrezik më të lartë nevojë për përkujdesje në një pavijon të kujdesit intensiv, nevojë për intubim në ventilator dhe vdekjeje nga sëmundje e rënduar.